REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr3408 Prot

Maliq, më 01.06.2026

VENDIM

Nr.66, datë 29.05.2026
Për

"Miratimin e shpërblimit me honorar për angazhimin e një koreografi për ngritjen e Ansamblit të Valleve Popullore pranë Qendrës së Kulturës Multifunksionale "Dhimitër Orgocka", Maliq"

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", Neni 64 "*Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë*", gërma "c", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", Ligji Nr.10352, datë 18.11.2010 "*Për kulturën*", Udhëzim nr.4, datë 04.02.2025 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin e Përgjithshëm nr.26, datë 08.09.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat*", si dhe në zbatim të buxhetit të miratuar të Bashkisë Maliq për vitin 2026, me qëllim zhvillimin e jetës kulturore dhe ngritjen e Ansamblit të Valleve Popullore, Këshillit i bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë shpërblimin me honorare për angazhimin e një koreografi, me qëllim ngritjen, përgatitjen artistike dhe drejtimin koreografik të Ansamblit të Valleve Popullore pranë Qendrës së Kulturës Multi funksionale "*Dhimitër Orgocka*", Maliq.

2. Angazhimi i koreografit do të realizohet përmes kontratës së shërbimit artistik, për një periudhë **6 (gjashtë) mujore**, me fond **500,000 (*pesëqindmijë*) lekë**;

3. Shpërblimi do të bëhet çdo muaj sipas orëve që do të realizohen.

4. Paga orare do të jetë **6,944** (*gjashtëmijë e nëntëqind e dyzet e katër*) lekë /orë, për 12 orë në muaj.

5. Fondi për shpërblimin me honorar do të përballohet nga buxheti i miratuar i Bashkisë Maliq për **vitin buxhetor 2026**, programi "*Kulturë, art dhe trashëgimi kulturore*";

6. Të kryhen proçedurat ligjore për lidhjen e kontratës së shërbimit;

7. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve Publike , Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për e zbatimit të këtij vendimi.

8. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të piks 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar.

Miratuar me 17 vota
Vota Pro 17
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 01.06.2026

KRYETARI I KËSHILLIT
Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ